

Njoftim për kërkim kandidaturash për ndjekje kualifikimesh

1	Titulli i kursit	Kolegji i Luftës i Ushtrisë Amerikane (program i studimit në distancë) / <i>US Army War College (Distance Education Program)</i>
2	Kriteret e kërkuara të gradës	N/Kolonel, Kolonel, Gjeneral brigade të sapo promovuar / Civil ekuivalent
3	Kriteret e kërkuara të gjuhës	Anglisht 80 + ECL dhe TOEFL 83+
4	Përshkrimi	Programi i studimit në distancë i Kolegjit të Luftës së Ushtrisë Amerikane (USAWC - <i>Distance Learning Program</i>) u jep oficerëve të përzgjedhur mundësinë për të ndjekur kursin në distancë për një periudhë me kohëzgjatje 2 (dy) vjeçare pa u shkëputur nga funksioni i tyre aktual. Kurrikula e kursit është e njëjtë me programin rezident në SHBA dhe ka për qëllim zhvillimin e personelit me aftësitë bazë profesionale në mënyrë që të marrin përgjegjësi në nivelet e udhëheqjes strategjike. Ky program kërkon nga pjesëmarrësit të përkushtohen 15 orë në javë në studimin e materialeve, leksioneve, plotësimit të detyrave dhe punëve kërkimore në mënyrë që të arrijnë objektivat e kursit. Pjesëmarrësit janë të detyruar të ndjekin nga afër 2 (dy) programe rezident, në kampusin e U.S. Army War College, USA, në periudhat e mëposhtme: - Në periudhën e fundit të vitit të parë akademik, 06.06.2027 deri më 27.06.2027 - Në periudhën e fundit të vitit të dytë akademik, 10.07.2028 deri më 25.07.2028.
5	Kritere të tjera	- Kandidati duhet të ketë kryer Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) ose ekuivalent. - Kandidati duhet të ketë shërbyer minimalisht 15 vite në strukturat e Forcave të Armatosura - Të ketë potencial për të mbajtur pozicione drejtuese pas përfundimit të kursit - Kandidati për të ndjekur programin master, duhet: a. Të kryejë testimin e gjuhës TOEFL. b. Të ketë ekuivalentuar, njësuar, përkthyer dhe noterizuar diplomën bachelor. c. Të ketë aftësi akademike për studim dhe kërkim në nivelin master. - Të jetë i aftë nga ana shëndetësore dhe fizike.

6	Periudha e zhvillimit të kursit	Korrik 2026- Qershor 2028
7	Vendi i zhvillimit të kursit	Online
8	Ekuivalentimi	Njësohet me KLO/KLSM
9	Afati aplikimit elektronik (sipas lidhjes 4)	09 Janar 2026
10	Kuota	1 (një) kuotë

***Procedurat e Aplikimit:**

1. Plotësohet Lidhja 4 duke shkarkuar formatin në “4. Formati i aplikimit individual për kualifikime institucionale ose funksionale brenda dhe jashtë vendit”

(<https://www.mod.gov.al/index.php/kurse-dhe-trajtime>)

2. Dergohet Email në: aplikim.qpr@aaf.mil.al

Vendos në “CC”: aplikim.shp@aaf.mil.al, aplikim.mm@aaf.mil.al si dhe për dijeni aplikanti në email të njoftojë strukturën eprorë të drejtpërdrejtë (degët dhe seksionet e personelit G1/A-1/N-1/S-1 dhe drejtorët e drejtorive sipas vartësisë).

**Shënim: Lexoni Kapitullin III të “Rregullore për aplikimin dhe përzgjedhjen e personelit të FARSH për arsimim dhe trajnim brenda dhe jashtë vendit, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 2175, Datë 23.11.2017”*

(https://www.mod.gov.al/images/njoftime2017/kursetrajtime/rregullore_arsimim_brenda_%20jashte_miratuar.pdf)